



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UJESJELLES KANALIZIME SH.A
S A R A N D Ë

Adresa : Gjashtë-Sarandë, Tel/Fax 0852 2 6264, NIPT J64228814D, email : shauk.sarande@gmail.com

Sarande me 11.12.2019

SPECIFIKIME TEKNIKE

PROJEKT : NDERTIM STACION I RI PUS-CPIMI NE VRION DHE LIDHJA ME RRJETIN KRYESOR TRANSMETUES

Paraqitje

Ky 'Specifikim Teknik', eshte hartuar nga grupi i projektimit per projektin "NDERTIM STACION I RI PUS-CPIMI NE VRION DHE LIDHJA ME RRJETIN KRYESOR TRANSMETUES".

Zerat e rradhitura ne permbajtje, jane pjese dhe pershkrime te detajuara te bera nga projektuesit si dhe specifikime te tjera te mundshme te kategorive te ndryshme.

1. SISTEMI I POMPES SE UJIT

1.a Hyrje

Ky seksion mbulon të gjitha punët që lidhen me furnizimin e pompave, sic jepet ne preventivin e punimeve ne vendin e propozuar, Stacioni pompimit, dhe pus shpimi Vrion, Sarande. Puna duhet të përfshijë realizimin e pusshpimit sipas te gjithave standarteve dhe kushteve teknike te projektimit dhe te zbatimit. Furnizimin e pompes të ujit me të gjithë aksesorët e nevojshëm për të pasur sistemet e pershtatshme duke përfshirë: pompat dhe motorët e tyre elektrik. Gjithashtu dhe pajisjet mekanike , hidraulike dhe elektrike qe do te duhen te vene ne funksion te plote investimin. Ky investim , duhet të përfshijë testet e kërkuara për të përfunduar punën siç përshkruhet në këto specifikime, vizatimet e kontratës dhe preventivin e punimeve.

1.b Sigurimi i cilesise

- a) Operatori Ekonomik do të ofrojë pompe te re dhe motorët elektrikë të përshtatshëm, te prodhuara nga prodhuesit e specializuar në projektimin dhe prodhimin e pompave te ujit dhe motoreve elektrikë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe duke qene ne treg për më shumë se 10 vjet.

- b) Operatori Ekonomik do të ofrojë panel elektrik te ri të përshtatshëm, të prodhuara nga prodhuesit e specializuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe duke qene ne treg për më shumë se 10 vjet.
- c) Keto pompa me motore elektrike dhe panele elektrike duhet të jene perdorur me sukset te pakten ne tre vende te tjera ne territorin e Shqiperise.
- d) Të gjitha materialet dhe komponentët e ofruar për këtë projekt duke përfshirë pompat, motorët, panelet elektike, pajisjet hidro-mekanike duhet të kalojnë testet e sigurimit të cilësisë në fabrikat që prodhohen këto materiale dhe Komponente, në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare. Kontraktuesi do të disponoje certifikatat e furnizimit që tregojnë se materialet e furnizuara kanë kaluar teste të tilla.

1.c Pershkrime dhe Informacione

- a) Informacione mbi pompen: Duhet të jepen vizatimet nga prodhuesi, rezultatet e testeve të pompës, kurbat e performancës, garancia dhe çertifikatë që miraton instalimin për pompën.
- b) Informacion për motorin pompës: Duhet të jepen vizatimet nga prodhuesi, karakteristikat e performancës, garancinë dhe certifikatën që miraton instalimin dhe përshtatshmërinë e motorit elektrik për funksionimin e vazhdueshëm e te suksesshëm të sistemit.
- c) Manualet e Operimit dhe Mirëmbajtjes: Duhet të jepen kopje të manualit Operacionit dhe të mirëmbajtjes; Që përmbajnë listën e plotë të pjesëve, mirëmbajtjen e rekomanduar calendar operimi dhe procedurat, si dhe udhëzuesin për menyren e funksionimit.
- d) Operatori Ekonomik duhet të dorëzojnë skemat e plota për stacionin e pompimit dhe të gjitha instalimet që do të zbatohen në zonën e stacionit, duke përfshirë tubat, valvulat, Pajisje dhe njësi të kontrollit elektrik, për miratim nga Autoriteti Kontraktor.

1.d Garancia

Operatori Ekonomik duhet të garantojë, sistemin e instaluar dhe qëndrueshmërinë e tij kundër defekteve gjate punes, për të paktën 3 vjet.

Prodhuesi i pompës duhet të garantojë furnizimin, me çdo pompë dhe motor elektrik Kundër defekteve gjate punës për 3 vite ose 9,000 orë pune.

1.e Referenca dhe Standarte

Në këte sektor, standardet Kombetare, kur është e përshtatshme për përdorimin, mbizotërojnë. Sidoqoftë, kur Standardet kombetare nuk mbulojnë një pjesë ose aktivitet të caktuar, do të përdoret standardi i përshtatshëm ndërkombëtar. Preferenca do t'i jepet standartit ISO.

2. MATERIALET

2.a Njesia Motor –Pompe

Kjo njesi duhet te perfshije kata component:

- a) Pompe Vertikale Centrifugale shumeshkalleshe dhe te gjithë aksesoret e nevojshem per te pasur nje sistem pune me specifikat e Prurjes (Qllog ≤ 75 l/s) dhe Prevalences (Hlllog ≥ 180 m) sic ajo paraqitet ne preventivin e punimeve Pompa Zhytесе per instalim brenda Pusi,
Diameter 10" (inch),
Dalja e lidhjes me tubacionin 6" me Adaptor DN150;
Motorri Zhytes i tipit T40, me fuqi 170 kW,
me startim Yll/Trekendesh (Star/Delta), 3x380-415 V,
rryma 365-365-375 A,
shpejtesia 2910-2920-2930 rpm;
Eficienca e Pompes per piken e punes se dhene jo me e vogel se 75%,
Ndersa eficienca e Pompes + Motorri jo me e vogel se 67-69 % ;
Pompa dhe Motorri prej material Celik Inox sipas standartiti EN1.4301 (AISI 304) ose ekuivalent ,
rezistent ndaj korrozionit,
Hermetizimi sipas standartit IP68 ose ekuivalent;
Aprovuar per Uje te pijshem sipas standartit ACS ose ekuivalent ;
numri i rrotullimeve 2910-2920-2930 rpm
Presioni maksimal i perballueshem 25 bar
- b) Pompat duhet të pajiset me një tabelë mbi te. Leximi te jete i qarte dhe te kete rezistencë ndaj korrozionit. Tabela duhet te përmbajnë informacion të plotë të pompës duke përfshirë: emrin e prodhuesit të pompës, numrin serial, numrin e modelit të pompës, numri i fazave te rrymes elektrike, shpejtësia, lartesia totale dinamike dhe prurja në m³ / orë ose litra / sekondë, viti i prodhimit etj.
- c) **Elektromotori:** duhet te jete me bosht vertikal, me induksion tre fazor, me kuti ftohjeje (fan cooling, squirrel cage), me shpejtesi maksimale 3000 rpm. Tensioni i instaluar ne voltage= 380 Vrms, 50Hz, Efficienca>90%, $\cos\phi >0.89$. Ngarkesa shtytесе=1.5 x ngarkesen e vleresuar, rezistence ndaj ujit te shkalles se larte (IP55) dhe izolim te rangut (F), me aks me levizje jo te kundert me mbrojtjen e duhur, te pershtatshme per te kryer funksionin e pompes se lartpermendur pa e mbingaruar, me thermostat, me aksin e levizjes, bashkusat, flanaxhat, bullonat, etj., dhe te gjitha rakorderite dhe kabllot e duhura per instalimin e njesise se pompes.

Specifikimet teknike te materialeve elektrike qe do te perdoren gjate ketyre punimeve paraqitet si me poshte :

3-SPECIFIKIMET TEKNIKE TE PANELIT ME SOFT STARTER 200 KW

- Dimensionet e panelit (Boksit) 400x200x600mm IP55.
- Automat 3P, 400-630 Amp.
- Kontaktor (leshues) 3P, 400-630 Amp.
- Soft Starter 420-620A me Display LCD.
- Butona Start-Stop te vendosura ne kapakun e panelit .
- Llampa pune dhe emergjence te vendosura ne kapakun e panelit.
- Rele Mbitensioni / Nentensioni.
- Siguresa 2-6 Amp g-g, bashke me bazamentin.
- Ventilator ajrimi me fileter per panelin 120x120

Specifikimet Teknike te Soft Starterit 200-250 kw.

- Te jete i Standartit CE.
- Start Current Rating (Amps) 400-630 A.
- Temperatura Operative (me deratizimin) $-10^{\circ}\text{C} \sim 60^{\circ}\text{C}$.
- Temperatura Storage - $10^{\circ}\text{C} \sim 60^{\circ}\text{C}$.
- Lageshtia 5% deri ne 95% Lageshtise Relative.
- Display LED
- Menyre nisje me rryme te programueshme.
- Kontrol i Torque.
- Ndalim i bute.
- I programueshem per rrymat nominale te motorrit.
- I programueshem per sekuencen e fazeve.
- I programueshem per asimetrine e fazeve.
- I programueshem per mbirrymat.
- I programueshem per nenrrymat.
- I programueshem per kohen e nisjes.
- I programueshem per kohen e ndalimit.
- Opsion per lidhje ne Distance.
- Te kete mbrojtje me Password.
- Te tregojte fuqine aktuale, rrymat, frekuencen etj ne motorr.

2-Specifikimet Teknike per kabell 3 x 240mm² per pompen 170 kw

- | | |
|--|--|
| - Numri i fijeve : | 3 |
| - Seksioni: | 240 mm ² |
| - Temperatura e punës: | $-5^{\circ}\text{C} \div +70^{\circ}\text{C}$ ne përçues. |
| - Tensioni nominal i punes: | 0,6/1 KV |
| - Temp maksimale e qarkut të shkurtër: | 250°C ne përçues (kohëzgjatja maksimale sekonda) |
| - Materiali i kabllit: | Baker i zhveshur |
| - Fleksibiliteti i kabllit: | Klasa fleksibile |

- Izolacioni:	PVC
- Rezistenca mekanike ndaj ndikimeve:	Mesatar
- Lakueshmëria e kabllit:	Fleksibile (i lakueshem)
- Temperatura maksimale e kabllit në shërbim:	70°C
- Temperatura maksimale e kabllit në qarkut të shkurtër:	160°C
- Standarti: Bakër fleksibël klasa 5 sipas standartit CEI EN 60228	
-Aplikimi	Per furnizimin e pompes te zhtytur ne pus

Mufte Hidroizoluese me xhel (rreshire)
fuqise me 6 fjet e kabllit te elektropompe.

Per xhuntimin e 6 fijeve te kabllit te

Kunder ujit.

Per kabell me seksion 95 mm².

4. SPECIFIKIME TEKNIKE PER KRYERJEN E PUS SHPIMIT

1. Te behet transporti i sondes dhe bazes material ne vendin e caktuar per hapjen e pus shpimit.
2. Te behet hapja e gropes se argjiles dhe sistemimi i sheshit te vendit per fillimin e punes.
3. Te behet shpimi i pusit me diameter :
600 mm per intervalin e thellesise 0.00 -52.00 m
4. Te behet kemishimi i pusit ne intervalin e thellesise:
600 mm per intervalin e thellesise 0.00 -52.00 m
5. Te behet tubimi i pusit me tubo dhe filtro me diameter 450 mm, spesor 8 mm, filtrot te ulen ne intervalin e thellesise 50 m
6. Te behet mbushja e hapesires midis trungut te puseve dhe tubove te shfrytezimit me granil lumi me permasa 5-10 mm, ne intervalin e thellesise 52 m deri ne 2 m nen siperfaqen e tokes. , kurse nga 2 m deri ne siperfaqe do te behet çimentimi per evitimin e ndotjes se ujrave siperfaqesore
7. Te behet larja e pusit me uje per nje periudhe 10 ore.

8. Te behet zhvillimi i pusit me kompresor duke ulur shtangat deri afer ballit te pusit, me zgjatje 10 ore, per pastrimin e ujit.
9. Te behet pompimi I pusit me pompe zhytесе me kapacitet 2 l/sek. per nje periudhe 72 ore, deri ne pastrimin e plote te ujit
10. Te behet matja e treguesve hidrogjeologjike te pusit , niveli statik, dinamik, prurja etj
11. Te merren prova uji per kryerjen e analizave kimike dhe bakterologjike te ujit.
12. Te hartohet relacioni hidrogjeologjik i pusit te shpimit se bashku me treguesit e rekomanduar per shfrytezim
13. Te behet çimentimi i grykes se pusit
14. Te vendoset kapaku prej llamarine me vrima per mbylljen e grykes se pusit.
15. Te betonohet dhe te krijohet platforme betoni pas grykes se pusit.
16. Heqja e makinerive dhe kthimi i sheshit ne gjendje fillestare

Punoi :

Ing. Hidro. Fatjon Beqiraj

Per Njesine e Prokurimit :

Ing. Elekt. Liljana Gjati

Ing. Hidro. Fatjon Beqiraj

Jur. Anila Vjери